

Emanuel Egbo: Barazimi, duhet te ishte rezultati me i drejte

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 30 Nentor 2013 16:32



Trajneri i Bylis, Emanuel Egbo pas ndeshjes se sotme me Kastriotin mendonte se barazimi ishte rezultati me e drejte, ndonese Bylis e humbi takimin. "Ishte nje ndeshje mjaft interesante. Te tre rezultat ishin te pranueshme. Barazimi duhet te ishte rezultat me i drejte. Ka qene nje ndeshje e barabarte. Goli i dyte i Kastriotit erdhi nga nje gabim i mbrojtes sone. Kampionati ne vazhdim parashikohet mjaft i veshtire, per vete formatin qe ka, ku ne perfundim te sezonit dalin nga Kategoria jo pak por kater skuadra, ndaj cdo ndeshje ne vazhdim konsiderohet finale ne vete", u shpreh Egbo pas perfundimit te takimit